

**VENDIM**  
**Nr.514, datë 13.5.2009**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË  
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I PIKËS SË HEDHJES SË  
MBETURINAVE, NË QYTETIN E BAJRAM CURRIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i pikës së hedhjes së mbeturinave, në qytetin e Bajram Currit.
  2. Shpronësimi të bëhet në favor të bashkisë së Bajram Currit.
  3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) m<sup>2</sup>, tokë bujqësore, me vlerë të përgjithshme shpronësimi 4 530 000 (katër milionë e pesëqind e tridhjetë mijë) lekë.
  4. Ky fond, prej 4 530 000 (katër milionë e pesëqind e tridhjetë mijë) lekësh, të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave në Bankën e Shqipërisë “Fondi i shpronësimeve”.
  5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 191 600 (njëqind e nëntëdhjetë e një mijë e gjashtëqind) lekë, të përballohen nga bashkia e Bajram Currit.
  6. Shpronësimi të fillojë më 30.5.2009 dhe të përfundojë më 30.8.2009.
  7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Proces gjyqësor”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të ketë përfunduar procesi gjyqësor dhe pasi të paraqesin dokumentacionin e plotë të pronësisë dhe vendimin e formës së prerë të gjykatës, pranë bashkisë së Bajram Currit.
  8. Bashkia e Bajram Currit të kryejë verifikimet për përputhshmërinë e sipërfaqeve, që shpronësohen, me numrat e pasurive në pronësi të pronarëve.
  9. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe bashkia e Bajram Currit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË “PIKËS SË HEDHJES SË MBETURINAVE B.CURRI”

| Nr.   | Emri     | Atësia | Mbiemri | Nr. pasurisë | Zona kadastrale | Lloji i pasurisë         | Çmimi                   | Sipërfaqja            | Vlera totale   | Shënime                                            |
|-------|----------|--------|---------|--------------|-----------------|--------------------------|-------------------------|-----------------------|----------------|----------------------------------------------------|
| 1     | Erenik   | Zenun  | Gjyriqi | 1/18         | 1347            | Tokë bujqësore (vreshtë) | 302 lekë/m <sup>2</sup> | 12000 m <sup>2</sup>  | 3 624 000 lekë | Proces gjyqësore<br><br>Pretendon<br>Ali Gjongecaj |
| 2     | Abdullah | Adem   | Gjyriqi | 1/16         | 1347            | Tokë bujqësore (vreshtë) | 302 lekë/m <sup>2</sup> | 3000 m <sup>2</sup>   | 906 000 lekë   | Proces gjyqësore<br><br>Pretendon<br>Ali Gjongecaj |
| Shuma |          |        |         |              |                 |                          |                         | 15 000 m <sup>2</sup> | 4 530 000 lekë |                                                    |

